**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT**

**KORÇË**

**VENDIM**

**Nr. 125 Datë 28.10.2021.**

**PËR**

## PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE PËR PROJEKTIN ME FINANCIM TE HUAJ (IADSA II)

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Sektori i Integrimit Europian si dhe Drejtoria e Financës, "Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave dhe të shpenzimeve për projektin me financim të huaj (IADSA II), duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin Plotësues nr. 4 datë 25.1.2021 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021", VKB nr. 147 datë 28.12.2020 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë Korçë", i ndryshuar, urdhrin nr. 12 datë 11.1.2021 "Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2021 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë" sipas programeve, i ndryshuar, udhëzimin nr. 8 datë 17.2.2003 "Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj" si dhe në Marrëveshjen midis Komitetit Menaxhues i IADSA dhe Bashkisë Korçë, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave në vlerën 10,341,897 lekë, për projektin me financim të huaj IADSA II.

2. Të miratojë rritjen e planit të shpenzimeve në vlerën 10,341,897 lekë, për projektin me financim të huaj IADSA II të detajuar me këtë strukturë buxhetore:

**3-** Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike **26 familje**, në shumën **32.840 lekë.**

**4-** Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, **është 150.720 lekë.**

**5-** Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga **fondi i buxhetit vendor** ,sipas kritereve specifike të miratuara **24 familje,** me fond prej **64.700 lekë .**

Ky fond është parashikuar si 6 % nga fondi i kushtëzuar, për bllok ndihmën ekonomike dhe nga fondi i buxhetit vendor, i miratuar me VKB nr.4 dhe nr.5 datë 28.01.2021.

**1**.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social** dhe **Drejtoria e Financës**

**2**.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
**Eva NAÇI**

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
**Erjon NEXHIPI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KORÇË -



Kodi Postar 7001, Lagjia 12. Blv. "Shen Gjergji" nr 12. Tel. +35582243353, email: info@bashkiakorce.gov.al